

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Draft akti dhe dokumentacioni shoqërues ka qendruar i hapur për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për periudhën kalendarike nga data 17.03.2023 deri më 14.04.2023.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Akti është paraprirë me takime individuale dhe në grup me përfaqësues të ndryshëm të ekosistemit të *startup*-eve, përgjatë katër mujorit të tretë të vitit 2022 dhe përgjatë muajve janar-shkurt 2023.

Këtu veçohen takime me përfaqësues të GIZ, si një nga mbështetësit e ekosistemit dhe një prej organizatave zbatuese të programit “EU for Innovation”.

Draft akti ka qendruar në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik për periudhën kalendarike nga data 17.03.2023 deri më 14.04.2023. Rezulton se publikimi ka patur 396 shikime dhe nuk ka patur kontribute apo komente të depozituar përgjatë kësaj periudhe.

Draft akti ka qenë objekt diskutimi i Komitetit të Inovacionit në mbledhjen e datës 08.03.2023.

Përsa i përket rregullimeve të veprimtarisë së nomadëve digjitalë, përfaqësuesit e MiSHMS kanë qenë pjesë Grupit të Punës së ngritur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me anëtarësi të strukturave të kësaj ministrie.

Në fund, veprimtaria e këtij Grupi Pune ka konkluduar me Memon e Grupit të Punës Nr. 852/1 prot., datë 08.02.2023, “Mbi nomadët digjitalë”.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

i. Aktorë të ekosistemit, 10 përfaqësues;

- përfitues nga Thirrja e Parë për masa mbështetëse, punonjës lëvizës digjitalë, donatorë dhe organizata jo qeveritare me fushë veprimtarie ekosistemin e *startup*-eve.

ii. Njësitë e Qeverisjes Vendore, 5 përfaqësues;

- përfaqësues të Bashkive përfituese nga mbështetja me grant.

iii. Këshillat Kombëtar Konsultativ

iv. Institucione shtetërore, 3 përfaqësues;

- SASPAC, AKSHI dhe Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;

v. Përfaqësues të akademisë, 12 përfaqësues;

- Përfaqësues nga institucionet akademike dhe profesionistë të kërkimit shkencor.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Lehtësimi i barrës fiskale për veprimtarinë e punonjësve lëvizës digjitalë.	Përrjashtimi i punonjësve lëvizës digjitalë nga rezidenca tatimore.	Punonjës lëvizës digjitalë, aktualisht veprojnë në Shqipëri	I pranuar	Interesi i përrhithjes së kapaciteteve teknike të huaja.
Afati për fazën e inkubimit për <i>startup</i> -et e regjistruara në Regjistrin Elektronik.	Lejimi i shtyrjes së afatit dyvjeçar i fazës së inkubimit.	Përfaqësues të <i>startup</i> -eve në fazën e idesë.	I pranuar	Lejimi i <i>startup</i> -eve në fazë ideje të vazhdojnë punën për rritjen e tyre.
Nevoja për përrmirësimin e menaxhimit dhe	Krijimi i një agjencie shtetërore që të jetë specifikisht e	Përfaqësues së institucioneve dhe	I pranuar	Rritja e cilësisë së menaxhimit

monitorimit të granteve, si dhe e përmirësimit të ofrimit të shërbimit të asistencës për ekosistemin.	ngarkuar për menaxhimin dhe monitorimin e granteve, si dhe të ofrimit të shërbimit të asistencës për ekosistemin.	të ekosistemit të <i>startup</i> -eve.		dhe monitorimit të granteve, si dhe shërbimit të asistencës për ekosistemin.
---	---	--	--	--